



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-72 datë 21.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-72 datë 06.03.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-910/2 datë 07.03.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 10-të mbajtur më 07.03.2025, miratoi:

**AKTVENDIM**  
**për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen**  
**e lejes për transmetim në radio**

**NDALLET** procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133 datë 07.09.2023.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, me Konkluzion ark.nr.02-737/5 datë 24.02.2025, miratoi propozimin e dr.Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-72 datë 21.02.2025 dhe inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133 datë 07.09.2023, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-754/1 datë 21.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), përkatësisht nuk paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia me datë 25.02.2025, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-72 datë 25.02.2025, për njoftim se nëse nuk paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 shihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



**Агенција за аудио и  
аудиовизуелни  
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38  
1000 Скопје  
Република Северна  
Македонија**

**Тел. + 389 2 3103 400**

**[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)**





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

Megjithatë, më 06.03.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-754/2 datë 06.03.2025 se SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, më 05.03.202, ka kryer pagesë në shumë prej 45.876,00 (dyzet e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) denarë, nga ku transmetuesi kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>2</sup> të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-72 datë 21.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-72 datë 06.03.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-910/2 datë 07.03.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 10-të mbajtur më 07.03.2025, vendosi ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër është marrë aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridikr:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

---

<sup>2</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).